REPUBLIKA E KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRË NË DORËZIM PRIMLJENO RECEIVED

| Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Annex | Vlera Vrednost Value |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 052 | 36700 | 2 |


# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA

## KOMUNA E SUHAREKËS

MUNICIPALITY OF SUHAREKA

### Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

| | |
| --- | --- |
| **Për:** | Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës |
| **Nga:** | Enver Shabani, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë |
| **Lënda:** | Raporti gjashtë mujor ***01.01.2022-21.06.2022*** |
| **Protokoll** | 201 |
| **Datë:** | 21.06.2022 |

Në bazë të urdhëresës së Kryetarit mbi raportin e punës gjashtë mujor nga data ***01.01.2022-21.06.2022***, ku gjatë periudhës gjashtë mujore kemi punuar si më poshtë :

**Sektori i Shërbimeve publike**

Në koordinim me zyrtarët e drejtorisë , kemi pranuar 200 lëndë, po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi vizituar dhe kthyer përgjigje për palët.

Kryerja e faturave të ujit,rrymës,telefonit,mbeturinave, projekteve të ndryshme, si dhe shumë faturave të komunës.

Përgaditja e kërkesave të KEDS-it për pëlqimet konkrete të tyre si dhe pëlqimeve të qytetarëve, kërkesa të shpeshta në KEDS, për vendosjen e njësorëve të rrymës si dhe shumë kërkesa të ndryshme sipas nevojës së Komunës.

Në projektin Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit e kemi realizuar projektin 100 %, ku janë pastruar, mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale në komunë, larja e rrugeve, mirëmbajtja dhe pastrimi i shesheve ne komune, mirëmbajtja dhe pastrimi i varrezave, largimi i mbeturinave shtazore, largimi dhe transporti i mobiljeve shtepiake me vellim te madh.

- Po ashtu projekti mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit është nënshkruar në muajin Mars, është projekt 12 mujor. Vlera e projektit arrin 137,066.42 euro. Ku deri më tani e kemi realizuar 118,993.25 Euro apo 86.81 %.

  - Pastruar rrugët qytetit me një distancë prej 185679 m',
  - Larja dhe rrugëve lokale ne qytet me një distancë prej 123786 m',
  - Mirëmbajtja dhe pastrimi i shesheve, shtigjeve te ecjes, lapidareve me një hapësirë prej 134400 m2,
  - Pastrimi dhe mirëmbajtja e gjelbërimeve, varrezave te qytetit me një hapësirë prej 34,416 m2,
  - Mirëmbajtja e gjelbërimeve ne parqet, sheshet, shtigjet e ecjes etj me nje hapësirë 213248 m2,
  - Mirëmbajtja dhe pastrimi i shtratit të lumit me një distancë 400 m'.
  - Ujitja e hapsirave të gjelberuar 21281 m2,
  - Mirëmbajtja e banesave kolektive me sasi prej 288 sosh.
  - Largimi dhe transporti i mbeturinave shtëpiake me vëllim të madh 182.7 ton,
  - Largimi i mbeturinave shtazore 85 copë.

- Pothuajse gjatë tërë kësaj periudhe kemi pranuar dhe vizituar kërkesa të ndryshme.
- Gjithsej 200 kërkesa (100%),

    - Me aktpercjellës 8, (4%)
    - Të miratuar 86 , (43%)
    - Të refuzuar 64 , (32%)
    - Në proces 42, (21%)
    - Hedhur posht 0
    - Pezulluar 0

## Mirëmbajtja dimërore e rrugëve





Bashkëpunimi në mes Komunës së Suharekës dhe JICA Japoneze ka vazhduar edhe këtë vit ku ka filluar "Projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh-Faza e dytë " nga qershori 2021 dhe do të vazhdojë deri në prill 2024, ku kemi pas takime të shumta mes përfaqësuesve të JICA dhe Komunës, për të cilët jemi shumë falenderues për punën dhe bashkëpunimin që kanë treguar duke n'a ofruar ndihme të jashtëzakonshme.





Memorandum Mirëkuptimi Ndërmjet Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara dhe Komunës së Suharekës( dt. 19.01.2022), projekti " Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën" ku Qëllimi i këtij projekti është të zvogëloj emetimet e gazrave serrë (GS) dhe të kontribuojë në zhvillimin neutral ndaj karbonit përmes një qasjeje të integruar dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për të mbështetur vendimarrjen e informuar përmes të dhënave, me fokus të shtuar në zonat rurale, dinamikën midis zonave rurale dhe urbane, platformave sociale inovative,sistemet ushqimore dhe financimin për të mundësuar një rimëkëmbje të gjelbër nga COVID 19.
Kemi filluar menjëher takimin me 26.01.2022 për formimin e grupit punues.



Po ashtu bashkëpunimi në mes Komunës së Suharekës dhe Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" ka vazhduar edhe këtë vit. Pas kërkesave të qytetarëve për ndërtimin e shtëpive Drejtori z.Enver Shabani së bashku me Nënkryetaren e Komunës znj. Mihrie Suka vizituan disa familje, për të parë nga afër gjendjen e jetesës së tyre me datë 21.02.2022.





**Gjithashtu takimet e rregullta pune kanë vazhduar për një performancë dhe punë sa më të mirë të drejtorisë të organizuara nga Drejtori z Shabani me stafin si dhe me koordinatorin z.Fatos Kuqin.**



**Fuqizimi i Veprimit Lokal Klimatik (SLCA)**

Në takimin e mbajtur me 02.03.2022, në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP), tek salla e konferencave, në Prizren, për Fuqizimin e Veprimit Lokal Klimatik, përfaqësues të Komunës së Suharekës kanë qenë: nënkryetarja e Komunës znj.Mihrije Suka, Enver Shabani, drejtor i Shërbimeve Publike dhe zyrtari nga kjo drejtori Berat Kabashi.
Janë prezantuar rezultatet kryesore të projektit të përfunduar Urban NAMA, si dhe projekti i ri SLCA, i cili do të zbatohet në komunat e Prizrenit dhe Suharekës.
Nënkryetarja Suka, në fjalimin e saj duke e prezantuar Komunën e Suharekës, ndër të tjerash ka thenë: "Komuna e Suharekës ka të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me UNDP dhe ADA, marrëveshje e nënshkruar nga kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj dhe ne si përfaqësues në këtë takim të Komunës së Suharekës zotohemi se do t'i qëndrojmë besnik kësaj marrëveshje në të mirë të të gjithë qytetarëve".
Po ashtu Komuna e Suharekës ka bërë një thirrje publike për formimin e Grupit Punues, me qëllim të dhënies së ideve dhe praktikave profesionale, i përbërë prej 30 anëtarëve nga zyrtarë komunal, përfaqësues të bizneseve, OJQ, gra fermere, nga komunitetet dhe ekspertë të fushave mjedisore



Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar takim edhe me organizatën **CEDE - Center for Education and Development of Environment** për menaxhim të mbeturinave me qëllim të diskutimit mbi gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave, nevojat dhe për mundësitë e përmirësimit të këtij sektori. Për t'i arritur këto qëllime fillimisht u dakorduam që të formohet një grup punues për menaxhimin e mbeturinave nga të gjitha grupet e interesit. ( dt. 01.03.2022)



**Në kuadër të GIZ projektit " Përkrahja e Proceseve Reformuese për Integrimin në BE" dhe Inspektoratit të Ministrisë, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është mbajtur tryeza e dytë duke përfshirë komunat e regjionit të Prizreni ku u shtjellua tema " Kompetencat dhe sfidat e inspektorateve në nivel qendror dhe lokal" ( 15.03.2022 -Prizren)**



**Me Vendim të Kryetarit të Komunës të dates 15.02.2022 dhe nr. Të protokolit 01-Nr.410-9723 është formuar grupi punues ( Enver Shabani, Driton Maliqaj, Afrim Bytyqi, Fisnik Tahiri, ismet Krasniqi dhe Agim Bylykbashi) për hartimin e asryeshmërisë, biznes planit dhe të gjitha dokumentet për themelimin e ndërmarrjes publike, ku edhe u mbajt takimi i parë i grupit punues për formimin e ndërmarrjes publike me datë 16.03.2022, ku po ashtu u diskutua për detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues për hapat e mëtutjeshëm.**



**Fuqizimi i veprimit lokal për klimën-punëtoria e pare e këtij projekti ( 16.03.2022)**

UNDP, ka organizuar tryezën e takimit për projektin "Fuqizimi i veprimit lokal për klimën".
Enver Shabani, drejtor i Shërbimeve Publike, është i emëruar udhëheqës i këtij projekti profitabil për Komunën e Suharekës. Ai e ka hapur takimin dhe i ka përshëndetur të pranishmit për pjesëmarrje, duke vazhduar me një rezyme lidhur me projektin.Ndërsa përfaqësuesit nga UNDP, kanë dhënë sqarime për projektin që do të realizohet në Komunën e Suharekës, i cili lidhet direkt siç e kanë quajtur ata projekti i natyrës unike për ndryshime klimatike.
Pjesë e takimit ka qenë edhe nënkryetarja e Komunës znj.Mihrije Suka, e cila është edhe anëtare e ekipit për projektin në fjalë si dhe zyrtarë të tjerë komunal e po ashtu edhe përfaqësues nga sfera të ndryshme.





*Drejtori i Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjenca, Enver Shabani, dhe Drejtori i Bujqësisë Ardian Kotori kanë marr pjesë në tryezën e organizuar nga OSBE me temën; Forcimi i reagimeve ndaj rreziqeve të sigurisë nga ndryshimet klimatike. Studim parafizibiliteti - Zona e maleve të Sharrit dhe masivit të Korabit. ( 31.03.2022).*



Gjatë muajit Maj kemi marr pjesë së bashku me Nënkryetaren e Komunës znj.Suka dhe Drejtoreshën e Admninsitratës Publike znj. Bajraktari në **"Forumin e zhvillimit ekonomik në nivel lokal dhe regjional"**

**26 Maj 2022/Ankara**



**Takimet dhe bashkëpunimi me JICA-Japoneze vazhdon, këtë vit fillon edhe implementimi i pilot projektit. (24.05.2022)**





**Inspektori I preventives së Zjarrit**

Duke u bazuar ne planin vjetor të punës, periudha janar-qershor e ketij viti ka kaluar në kryerjen e punëve të lemisë së parandalimit të zjarrit, të kryerjes të inspektimeve fillestare,të rregullta,të inspektimeve kontrolluese, daljes në vendin e ngjarjes me rastin e zjarreve,dhe punë tjera të mbrojtjes nga zjarri.

Puna në teren, kontakti me njerëz të institucioneve të ndryshme,udhëheqës të ndërmarrjeve apo kompanive të ndryshme, përveq rolit inspektues e ka edhe rolin këshillue dhe edukativ, gjithmonë ne shërbim të parandalimit të zjarrit, shpëtimit të pasurisë dhe jetës së njerëzve.

Numri i madh i zjarreve në periudhen e verës të vitit të kaluar dhe dëmet e shkaktuara nga zjarri, ka bërë që të jemi me vigjilent duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet komunale,si dhe njerëz që direkt ballafaqohen me zjarret në teren.

Këto ditë do të bëjmë shpërndarjen e një Apeli nëpër të gjitha fshatrat e komunës si dhe të ndërmarrjeve të ndryshme që të marrin masat parandaluese nga zjarri në sezonin e verës,duke i përdorur edhe mediat si mjet i rëndësishëm në senzibilizimin dhe parandalimin e zjarrit.Një vend të rëndësishem zen edhe sezoni i korrje shirjes me kontrollimin e autokombajnave mbi gjendjen e tyre teknike,dhe posedimin e pajisjeve zjarrefikese.

Më poshtë do të evidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Qershor 2022 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1.Inspektime fillestare....................................................................2

2.Inspektime të rregullta...............................................................23

3.Në sektorin Publik.......................................................................2

4.Në sektorin privat.......................................................................23

5.Inspektime kontrolluese..............................................................18

5.Masa të shqiptuara.......................................................................73

6.Aktvendime....................................................................................3

7.Pëlqime ne dok.investiv teknik......................................................3

8.Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve......................................4

9.Vërtetime........................................................................................4

10.Raporte..........................................................................................3

Me datë 17.05.2022 kemi pas një rast zjarri ku është djegur një kioskë pranë shkollës "7 Marsi" në Suharekë, ku kemi dalur në vendin e ngjarjes dhe kemi bërë hulumtimin e shkakut të zjarrit, ku dyshohej se shkaku i shpërthimit të zjarrit ishte një përçues elektrik.





**Sektori për infrastrukturë**

Gjatë periudhës gjashtëmujore: Janar 2022 - Qershor 2022, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2022. Janë bërë fillimisht hartimi i projekteve, hartimi i specifikimeve teknike, dhe pergatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave për projektet:

1. Ndërtimi i rrugeve lokale : "Haxhi Qerimi,"Hajdaraj"-segment në Baqevc
2. Ndertimi i trotuarit pergjatë rruges kryesore"Besa e Arbërit dhe kanalizimi ne lagjen e re në Breshancë
3. Ndertimi i rrugeve "Baki Izlami","Qarri" "Maliq Rama", "Osman Kadolli", Mentor Krasniqi,'Maliq Rama"etj në Bukosh"
   Ndertimi i rrugeve "Halil Izeti", Naser Baraliu", "Ukë Braliu","Naser Baraliu",Zelfije Sopa"etj *në Bukosh*
4. Ndertimi i rrugës "1 Tetori" dhe rrugët lokale ne Delloc në Delloc" dhe „ Ndertimi dhe asfaltimi i rruges "Burimi i Fshatit" në Delloc
5. Ndertimi i rruges rrethë shkolles qe lidhet me rr."Trimave dhe Xheladin Shala, "Hijet"-segmet etj në Doberdelan"
   „ Rregullimi i rrugëve; "Halil Hasani", "Halim Asllani", "Jahir Smajli", "Haxhi Xhemajlia"."Latif Gallopeni *në Doberdelan*
6. Ndertimi i rrugeve lokale: "21 Prilli" vazhdim, "Boka"vazhdim, në Drqagaqinë
7. Ndertimi i rrugeve " Xhezahir Maloku";"Kadri Ramadani"-segment;"Rrustem Dubrava"-segment;"Hamëz Fatahi"-segment në Dubravë"
   „Ndertimi i rrugeve,"Ramadan Dubrava"-segment, "Rrustem Dubrava"-segment;"Bafti Krasniqi"-vazhdim; "Haxhi Gashi"-segment në Dubravë
8. Ndertimi i rrugeve lokale: "Dalina"- seg varrezat, "Flamur Përteshi-segment" "Xhemajli Qatani" segment, Xhemë Qatani" "Eqerem Shukolli në Duhel" dhe
   „ Ndertimi i rrugeve lokale: "Xhemajl Trolli" "Shaqir Qatani" Sherif Qatani " segment dhe "Vëllëzrit Qatani" në Duhel
9. Ndertimi i rrugeve lokale; "Te Varrezat"; Rruga Fushore; në Dvoran" dhe „ Ndertimi i rrugeve Lokale "Diga",etj në Dvoran
10. Ndertimi i rrugeve"Sherif Qadraku"-vazhdim;" Daut Rexhepallari"; "Ahmet Izlami";" Qadraku";Qershia -segment ,etj në Gelancë" dhe
    „ Ndertimi i rrugeve "Azman Alija", "Halim Selimi","Fisniket", "Qershia","Ibish Halili në Gelancë
11. Ndertimi i rrugeve lokale:"Sherif Aga","Pavaresia"-segment, "Esat Rexhepi","Lugjet e Verdha"-segment,etj në Gjinoc
12. Ndertimi i rrugeve lokale: "Hut Halimi", "Bajram Syla"etj në Grejkoc"
    „ Ndertimi i rreth rrotullimit te lapidari *në Grejkoc*
13. Ndertimi i rrugeve lokale në lagjen BOKA-vazhdim, "Hajriz Xhema"dhe "Tetë Vëllëzrit". në Grejqevc" dhe „ Ndertimi i rrugeve lokale në lagjen BOKA-vazhdim në Grejqevc
14. Ndertimi i rregeve"Fejz Koliqi Gashi" asfallt në Javor" dhe „ Ndërtimi i rrugëve" Smajl Sadria","Isuf Meta"në Javor
15. Ndertimi i rrugës Kastërc - Breshanc- vazhdim dhe rrugë të tjera lokale në Kasterc" dhe „ Ndërtimi i rruges "Mejdi Haradinaj" dhe rruge te tjera lokale në Kasterc
16. Ndertimi i rrugeve lokale "Shtabi"- vazhdim në Krushicë të Epërme

17. Ndertimi i rrugeve" Lagja Lumit", Gashve, dhe Lagja e Re në Krushicë të *Poshtme*
18. Ndertimi i rrugës Ndertimi i rrugeve lokale: "Hut Halimi", "Bajram Syla"etj në Grejkoc"
    „ Ndertimi i rreth rrotullimit te lapidari *në Grejkoc*
19. " Vesel Pagarusha" segment "Afrim Buqa" segment dhe rrugë të tjera lokale në Luzhnicë
20. Ndërtim i rrugëve: "Regjep Velia"- me segment, "Molika", "Shaljanet"-segment,"Kovaqi", "Tafa", "Jetush Shala", "Haxhi Shania" etj në Mushtisht
21. Ndertimi i rrugeve lokale te fshatit në Popolan
22. Ndertimi i rrugeve lokale „Lagja Tafolli-Lagja Vrella"-vazhdim në Qadrak"
23. Ndertimi i rrugeve lokale: "Nëntori i Dytë", "Xhemajl Morina", "Mehmet Bytyqi" segment, etj. në Reshtan
24. Ndërtimi i rrugës: "Vatra", "Dodona", "Molla e Kuqe", "Xhevë Lladrovci-vazhdim", "Demir Demiraj"-segment, "Bahri Fazliu", "Fehmi Agani"-vazhdim, "Fatmir Bylykbashi", "Bregu i Jazit","Jeton Kabashi-segment" në Samadraxhë."
    „Ndërtimi i rrugës:,"Gusia","Mulla Idriz Gjilani", "Vaqe Zela", "Pashtriku", "Lulzim Bylykbashi"-segment, "Feim Morina"-segmente *në Samadraxhë*
25. Ndertimi i rruges "Martiret e Lirisë" dhe rregullimi i shtratit të lumit me beton në Semetisht" dhe „Ndertimi dhe riasfaltimi i rruges"Ukë Bytyçi" ne Semetisht
26. Ndertimi i rrugeve lokale " Deshmort Bytyçi";"Brigada 123 "-segmenet; "Besim Ndreca" -segment, "Fetah Gega"- segment në Shirokë" dhe „Ndertimi i rrugeve lokale: "Deshmoret e Atlantikut" -segment ne Shirokë
27. Ndertimi i rrugeve ",Haxhi Dan Brahimaj", "Nderi I Kombit" segment; "Azem Sopa" segment; "2 Prilli" segment"; "Fadil Elshani" segment"; "Fadil Kabashi" segment në Sopijë"
    „ Ndertimi i rrugeve "Nuhi Berisha", "Shpetim Sadikaj", "Beqir Berisha" etj *në Sopijë*
28. Ndertimi i rrugeve lokale ne Stravuqinë" dhe „ Zgjërimi i rrugës kryesore "Zenel Morina në Stravuqinë
29. Ndertimi i rrugeve "Vardari"-asfalt,"25 Marsi"-segmet, etj. në Tërrnje
30. Ndertimi i rrugëve lokale;" Ushtari i Lirirs" - vazhdim, "Abetarja" në Vërshec
31. Ndertimi i dhe zgjerimi i rruges "Te Antena tek rrafshi "Te quka", segment i rrugës "Ali Loshi në Vraniq
32. Ndërtimi i rrugëve lokale "Presheva", "Mali", "Quka" "Flaka e Qershorit" , "Martirët e Bllacës" "Riza Bllaca"-vazhdim, "Pajtimi", "Livadhi i Lekës,"Imer Krasniqi"-Segment në Bllacë" „ Ndërtimi i rrugëve lokale " Bregu", "Fjolla", "Koretniku", "Bashkim Suka", "Rr UÇK-së", "Bllacjanët" ,"Dukagjini", "Mehmet Suka", "Beteja e Bllacës"etj *në Bllacë*
33. Ndertimi rrugëve "3Korriku" " Zejnullah Kokollari" "Hoxhë Bajraktar" " Mehmet Kameri" "Kroi i Fshatit" ,"Bujar Buzhala"-segment,"Mursel Buqa"-asfalt në Budakovë"
    „ Ndertimi i rrugëve; , "Agron Palushi" "Mursel Buqa" etj *në Budakovë*
34. Ndertimi i rrugeve lokale, "Bashkim Kabashi"-segmente, "Mbreti Pirro","Vitia","Haxhi Elshani", etj në Leshan
35. Ndertimi i rrugeve Lokale, ‚Hamëz Bajrami dhe Ram Ahmeti"-vazhdim" "Shaban Nuha"në Maqitevë dhe „ Ndertimi i rruges "Nebih Islami", "Haradinajt" në Maqitevë
36. Ndertimi i rrugeve "Jetish Kabashi" segment, "Dermish Kabashi", "Zeqir Kabashi", „Mehmet Gashi" , "Sokol Kabashi","Riza Gashi", "Azem Kabashi", "Fazli Kabashi" segmente etj në Mohlan" dhe „Ndertimi i trotuarit rreth rruges "Fazli Kabashi" në Mohlan
37. Ndërtim i rrugëve "Golemi" "Fitimtari", "Hysen Zeneli" segment, "Xhevxhet Kryeziu" segment etj në Nëpërbisht dhe
    „ Ndërtim i rrugëve „Sefer Azizi ", "27 Marsi", "Mal Hajdari" etj në Nëpërbisht

38. Ndertimi i rrugeve lokale: " Agim Hajdari","Beteja e Gallushes", Sejdi Bullaku "etj në Nishor" dhe „ Ndertimi i rrugeve lokale: " Rrahman Bytyqi", „Demir Hamza", Dy Guret"-vazhdim etj në Nishor
39. Ndertimi i rrugeve lokale "Luftetari i Lirise"-vazhdim në Papaz" dhe „ Ndertimi i rrugeve lokale "Kroi i Nikës" vazhdim në Papaz
40. Ndertimi i rrugeve, "Amurllah Hoxha", "Kolonja", "13 Korriku"dhe rruge te tjera lokale në Peqan dhe „Ndertimi dhe rregullimi i infrastruktures se ujesjellësit ne fshat në Peqan
41. Ndertimi i rrugeve lokale: segment i rrugës "Dëshmoret e Reqanit" rruga te lapidari i fshatit "Mijedin Ramadani", etj në Reqan dhe
„ Ndertimi i trutuarit pergjatë ruge kryesore "Lulzim Veselaj" në Reqan
42. Ndertimi i rruges: "Zef Tunaj" "Mehmet Aliaj"segment i rruges "9 Maji", "Avdyl Ramadani" në Sallagrazhdë
43. Ndertimi i rrugeve Lokale: "Misin Kadriaj", Lagja e Ndrecaj ", "Djemt e Lirisë", Hamzi Bytyqi" etj. në Savrovë
44. Ndertimi i rrugeve: "Bajram Meta", Hamdi Basha", "Ilaz Basha"-segmet, "Komandant Xhaviti" -segment etj në Sllapuzhan dhe
„ Ndertimi i rrugeve: "Komandant Xhaviti"-segmet dhe rruga Sllapuzhan-Bllacë në Sllapuzhan
45. Ndertimi i rrugeve „ , "Dëshmorët e Lirisë" -segment, "Vjosa", "Besnik Perzhaku" -segment, "Ylli', "Plepat" ,Pellumbat", "Manat", "Blerta", "Dredheza" etj në Studençan"
„Ndertimi i rrugeve, "Eqerem Qabej" -segment "Djerrinat", "Gurra e Fshatit", "Brezi i Artë" etj *në Studençan*
46. Ndertimi i rrugeve lokale; "Xhelal Kuçi"; "Kenan Halimi" -segment; "Naser Kelmendi" - dy segmente "Jetë Balia" dhe "Nën Tereza "- asfallt "Luigj Nikolla" -vazhdim, Bajram Curri"-segment, "Garibaldi" në Suharekë" dhe
„Ndertimi i rrugeve lokale; segment i rrugës "Skenderbeu" dhe rrugë të tjera lokale në Suharekë
47. Ndertimi dhe rregullimi i varrezave te reja ne fshat në Tërrnje

si dhe janë zhvilluar procedurat me kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave për projektet kapitale për infrastrukturë komunale si:

48. Ndertimi i zonave te gjelbruara dhe rekreative ne Komunë
49. Ndertimi i kanalizimit ne :Reqan, Mohlan, Krushicë, Budakovë, Buzhalë, Maqitevë, Vraniq, Savrovë, Mushtisht, Sopijë, Shirokë, etj
50. Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve në Komunë" Suharekë,Samadraxhë, Bllacë, Sllapuzhan, Peqan, Semetisht, Reshtan, Studençan, Kastërc etj
51. Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike"
52. Ndertimi dhe sanimi i rrugëve lokale ne Komune
53. Ndertimi i shtreterve te lumenjeve dhe mirembajtaja e tyre dhe Ndërtimi i urave në Komunë
54. MBIKQYRJA E PROJEKTEVE INVESIVE
55. Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen "Skenderbeu"- Suharekë
56. Ndertimi i nenstacioneve në fshatrat: Mushtisht, Savrovë, Vraniq, Budakove, Mohlan, Krushicë, Sllapuzhan, Semetisht, Nishor, Greikoc, Leshan
57. Ndertimi i trotuarëve dhe parkingjeve në qytetin e Suharekës (Deshmoret e Kombit) si dhe në fshatra.

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin: 2020 dhe 2021 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë duke u realizuar dhe duke u menaxhuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë dhe vazhdojnë edhe në vitin 2022, prej tyre:

1. Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike ne Komune
2. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale
3. Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit

Si dhe është bërë menaxhimi i projekteve të cilat janë: Projekte me Bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës:

- Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqezimi i rrugës Nacionale N25-Grejkoc -Rrafshi i Livadheve
- Ndërtimi i unazës – Krahu i djathtë – Suharekë
- Ndërtimi i rrugës Sopi – Shirokë ( Rrethrrotillimi Leshan L – 5850 M
- Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat ( Rruga Bashkim Gashi) - (Lagja Zekolli), Suharekë
- Ndertimi i rruges Mushtisht - Verbeshticë - Shtërpcë

Janë pergatitur Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave për projektet:

- Projekt me bashkëfinancim MZHR Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i mbikalimit – Hisar – lidhje e shtigjeve të Ecjes në të dy krahët e qytetit
- Projekt me bashkëfinancim MAPL Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në zonat rurale në Komunën e Suharekës
- Projekt me bashkëfinancim MMPHI Ndërtimi i Parkut dhe rregullimi i shtatoreve në qendër të fshatit Mushtisht
- Projekt me bashkëfinancim MMPHI Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Gjinoc - Novakë - Mamushë"
- Projekt me bashkëfinancim MMPHI Projekt me bashkëfinancim - Ndërtimi i rrugës Baçevc - Sallagrazhdë - Grejkoc - Korishë

Gjatë kësaj periudhe është punuar në bashkëpunim me UNDP, në projektin „ Fuqizimi i veprimit lokal për klimën", i cili mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit.

Poashtu janë bërë vizita të punimeve të cilat janë duke u zhvilluar në teren si dhe vizita sipas kërkesave të qytetarëve.

Përgatitja e referencave për punët e kryera sipas kontratave, të kërkuara nga Operatorët Ekonomik.

Janë duke u menaxhuar kontratat te cilat janë nënshkruar këto kontrata:

1. Ndertimi i rrugeve lokale: "Hut Halimi", "Bajram Syla"etj në Grejkoc"

„ Ndertimi i rreth rrotullimit te lapidari *në Grejkoc*

2. Ndërtim i rrugëve: "Regjep Velia"- me segment, "Molika", "Shaljanet"-segment,"Kovaqi", "Tafa", "Jetush Shala", "Haxhi Shania" etj në Mushtisht
3. Ndertimi rrugëve "3 Korriku" " Zejnullah Kokollari" "Hoxhë Bajraktar" " Mehmet Kameri" "Kroi i Fshatit" ,"Bujar Buzhala"-segment,"Mursel Buqa"-asfalt në Budakovë" „ Ndertimi i rrugëve; , "Agron Palushi" "Mursel Buqa" etj në Budakovë

4. Ndertimi i rrugeve lokale:"Sherif Aga","Pavaresia"-segment, "Esat Rexhepi","Lugjet e Verdha"-segment,etj në Gjinoc
5. Ndertimi i rrugeve ",Haxhi Dan Brahimaj", "Nderi I Kombit" segment; "Azem Sopa" segment; "2 Prilli" segment"; "Fadil Elshani" segment"; "Fadil Kabashi" segment në Sopijë"

„ Ndertimi i rrugeve "Nuhi Berisha", "Shpetim Sadikaj", "Beqir Berisha" etj *në Sopijë*

*6.* Ndertimi i rrugeve „ , "Dëshmorët e Lirisë" -segment, "Vjosa", "Besnik Perzhaku" - segment, "Ylli', "Plepat" ,Pellumbat", "Manat", "Blerta", "Dredheza" etj në Studençan"

„Ndertimi i rrugeve, "Eqerem Qabej" -segment "Djerrinat", "Gurra e Fshatit", "Brezi i Artë" etj *në Studençan*

7. Ndërtimi i rrugëve lokale "Presheva", "Mali", "Quka" "Flaka e Qershorit" , "Martirët e Bllacës" "Riza Bllaca"-vazhdim, "Pajtimi", "Livadhi i Lekës,"Imer Krasniqi"-Segment në Bllacë" „ Ndërtimi i rrugëve lokale " Bregu", "Fjolla", "Koretniku", "Bashkim Suka", "Rr UÇK-së", "Bllacjanët" ,"Dukagjini", "Mehmet Suka", "Beteja e Bllacës"etj *në Bllacë*
8. Ndertimi i rruges rrethë shkolles qe lidhet me rr."Trimave dhe Xheladin Shala, "Hijet"-segmet etj në Doberdelan"

„ Rregullimi i rrugëve; "Halil Hasani", "Halim Asllani", "Jahir Smajli", "Haxhi Xhemajlia"."Latif Gallopeni *në Doberdelan*

9. Ndertimi i dhe zgjerimi i rruges "Te Antena tek rrafshi "Te quka", segment i rrugës "Ali Loshi në Vraniq
10. Ndertimi i rrugeve "Baki Izlami","Qarri" "Maliq Rama", "Osman Kadolli", Mentor Krasniqi,'Maliq Rama"etj në Bukosh"

Ndertimi i rrugeve "Halil Izeti", Naser Baraliu", "Ukë Braliu","Naser Baraliu",Zelfije Sopa"etj *në Bukosh*

11. Ndertimi i rrugeve " Xhezahir Maloku";"Kadri Ramadani"-segment;"Rrustem Dubrava"-segment;"Hamëz Fatahi"-segment në Dubravë"

„Ndertimi i rrugeve,"Ramadan Dubrava"-segment, "Rrustem Dubrava"-segment;"Bafti Krasniqi"-vazhdim; "Haxhi Gashi"-segment në Dubravë

12. Ndertimi i rrugeve lokale: "Dalina"- seg varrezat, "Flamur Përteshi-segment" "Xhemajli Qatani" segment, Xhemë Qatani" "Eqerem Shukolli në Duhel" dhe

„ Ndertimi i rrugeve lokale: "Xhemajl Trolli" "Shaqir Qatani" Sherif Qatani " segment dhe "Vëllëzrit Qatani" në Duhel

13. Ndërtimi i rrugës: "Vatra", "Dodona", "Molla e Kuqe", "Xhevë Lladrovci-vazhdim", "Demir Demiraj"-segment, "Bahri Fazliu", "Fehmi Agani"-vazhdim, "Fatmir Bylykbashi", "Bregu i Jazit","Jeton Kabashi-segment" në Samadraxhë."

„Ndërtimi i rrugës:,"Gusia","Mulla Idriz Gjilani", "Vaqe Zela", "Pashtriku", "Lulzim Bylykbashi"-segment, "Feim Morina"-segmente *në Samadraxhë*

14. Ndërtimi i rrugëve "Golemi" "Fitimtari", "Hysen Zeneli" segment, "Xhevxhet Kryeziu" segment etj në Nëpërbisht dhe

„ Ndërtim i rrugëve „Sefer Azizi ", "27 Marsi", "Mal Hajdari" etj në Nëpërbisht

Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha projektet kapitale nga fondi burimor Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ( BKK-10).

**Sektori për Mjedis**

Përmes kësaj shkrese ju raportojmë se Zyrtari për Mbrojtje të Mjedisit gjatë muajve të lartëpërmendur të 01.01.2022-20.06.2022 ka kryer aktivitete të cilat kanë qenë të parapara me kontratë dhe sipas përshkrimit të vendit të punës si dhe detyra tjera shtesë jasht përshkrimit të vendit të punës.

Zyrtari per mbrojtje te mjedisit kryesisht eshte marre me:

- Përgjegje në shkresa të ndryshme mjedisore, mvaresisht nga karakteri i tyre.
- Percjellje te proceseve dhe planeve te ndryshme me karakter mjedisor.
- Dalje ne teren per lëndë të caktuara dhe monitorim te projekteve.
- Përgaditja e LMK-ve sipas kërkesave të palëve , ku janë regjistruar 3 LMK dhe janë lëshuar dy (2)
- Vizit punimeve në terenë sipas kontratave të cilat janë në menaxhim.
- Përgaditja e Pelqimeve në parim sipas kërkesave janë regjistruar 5 , janë leshuar 4 Pëlqime në parim .

## Sektori për Emergjencë

Raport I intervenimeve të NJPZSH Janar - Qershor 2022

| Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2022 | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | Nr.i përgj. i daljeve | Nr.i zjarreve | Nr. i Teknike | Nr.i shërbimeve | Aksidente rrugore | Vërshime | Të rrejeh | Të lënduar | | | Të vdekur | | |
| | | | | | | | | zj. | gyt. | tot | zj. | gyt. | to |
| **Janar** | 19 | 15 | 1 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 | 3 | 0 | 1 | 1 |
| **Shkurt** | 15 | 14 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| **Mars** | 54 | 48 | 1 | 2 | 3 | 0 | 0 | 0 | 4 | 4 | 0 | 0 | 0 |
| **Prill** | 18 | 15 | 0 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 | 2 | 2 | 0 | 1 | 1 |
| **Maj** | 22 | 8 | 7 | 5 | 1 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| **Qershor** | 15 | 6 | 2 | 5 | 1 | 1 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| Korrik | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gusht | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shtator | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Tetor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Nëntor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dhjetor | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejtë** | 143 | 106 | 11 | 12 | 11 | 1 | 1 | 0 | 15 | 15 | 0 | 2 | 2 |

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Sinqerisht !

DREJTORI :

Enver Shabani